



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 44 Prot.

Tiranë, më datë 07.02.2019

VENDIM

Nr. 29, datë 07.02.2019

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT ZHVILLIMOR

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48, pika 1 dhe neni 134, pika 1, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 07.02.2019, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit hidroenergjitik: “Hec Gurshpat 4”, mbi përroin e Sulkuqit, degë e lumit Gostimë, që derdhet në lumin Shkumbin, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan, me subjekt aplikues “SITA PARTNERS” sh.p.k..
 - *Shoqëria të kontribuojë për restaurimin pjesor të objektit monument kulture: “Ura antike e Keçit” Nj ësia administrative Polis, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan.*
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 144, neni 145 dhe nenit 146;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elva MARGARITI

SEKRETAR I KKR

Arta DOLLANI

